

# KESHILLI RREGULLIMIT TE TERRITORIT BASHKIA KORCE

## VENDIM

Nr. 10 Date, 14.07.2007

### Miratim i rregullores se brendeshme te urbanistikes per kerkesat ne ndertim

K.RR.T. Bashkise, ne mbledhjen e saj te dates se sotme, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sekretaria Teknike e KRRT, mbeshtetur ne Ligjin "Per Urbanistiken", Nr. 8405, date, 17. 09. 1998, Neni 20, 26 dhe ne VKM nr.455, date 23.06.2005 "Per shpalljen "Qender Historike" dhe "Ansambel Urbanistik, Arkitektonik, Tradicional" te disa zonave te qytetit te Korces, si dhe per miratimin e rregullores se administrimit te tyre",

### VENDOSI:

#### **1. Te miratoje rregulloren e brendeshme te urbanistikes per kerkesat ne ndertim :**

- Ne zbatim te ligjit 8405 dt. 17/09/1998 "Per urbanistiken (neni 22 ). Prane drejtorise se urbanistikes paraqiten kerkesat e meposhtme :

- |                                   |  |
|-----------------------------------|--|
| 1- Kerkese per studim urbanistik  | (neni 32 ligji nr. 8405 dt.17/09/1998) |
| 2- Kerkese per leje sheshi        | (neni 39 ligji nr. 8405 dt.17/09/1998) |
| 3-Kerkese per leje ndertimi       | (neni 45 ligji nr. 8405 dt.17/09/1998) |
| 4- Kerkese per leje shfrytezimi   |  |
| 5- Kerkese per legalizim ndertimi | (ligji nr.9482 dt.16.02.2006)          |

- Llogaritja e kohezgjatjes per dhenien e pergjigjes per kerkesat e mesiperme fillon me depozitimin e kerkeses prane zyres perkatese te sekretaries teknike
- Kerkesa depozitohet prane zyres se urbanistikes
- Nese ne dokumentacionin perkates ka mosperputhje midis formulareve dhe fleteve te vizatimit, ose ka parregullsi ne dokumenta, zyra perkatese qe pranon dokumentat, evidenton mungesat ose pasaktesite dhe dhe kthen mbrapsht dokumentacionin si te pa plote brenda afatit te 15 diteve, sipas ligjit nr 8405, date 17.09.1998 "Per urbanistiken".

### KERKESAT PER STUDIM URBANISTIK

- Dokumentet e nevojshme per miratim studimi urbanistik pjesor :

#### 1- **Relacion** ku te shprehen :

- a- Analiza e gjendjes egzistuese e cila te specifikoje pozicionin e zones tuaj ne raport me qytetin dhe zonat fqinje me te, elementet e mbartur nga plane te shkalleve me te larta si p.sh plane rregulluese apo cdo lloj masterplani pjese e te cilit ka qene edhe zona ku ju punoni, elementet e te cilit propozohen te ruhen apo te prishen (ndertesa, rruge , elemente natyrore, etj ) se bashku me argumentimet perkatese.
- b- Bazuar ne analizen e mesiperme relacioni duhet te pershkruaje idete kryesore mbi konceptimin urbanistik – arkitektonik te zones nga ana juaj dhe si jane interpretuar dhe materializuar keto ide ne shperndarjen e zonave dhe funksioneve kryesore ne projekt idene e propozuar.

- c- Tabellen e bilancit te territorit se bashku me treguesit per dendesite dhe numrin e apartamenteve dhe banoreve per ndertesa mbi 5 kate edhe ne rastet kur behet studimi i bllokut te banimit. Keta treguesa te shoqerohen me nje analize krahasuese te treguesve qe rekomandohen nga rregullorja e urbanistikes. Pervec te tjerave kjo analize duhet te permbaje dhe arsyetimet perkatese ne rast se keto norma jane me te ulta ose me te larta se ato te rekomanduara.
- 2- **Planimetri e gjendjes egzistuese** ku te evidentohen analizat paraprake. Ne mënyre te veçante kjo flete do te paraqesë klasifikimin e objekteve sipas tipologjisë dhe funksioneve ekzistuese, evidentimin e elementeve natyrore dhe çdo elementi tjetër te spikatur te territorit qe do te përdoren si elemente kompozicional. Me shenja konvencionale te vecanta te tregohen objektet ne ruajtje dhe ato qe do te propozohen te prishen .
  - 3- **Planimetri te qytetit** (plane rregulluese ose harta te te qytetit ) ku te tregohet zona e studiuar si dhe rekomandimet qe japin planet e niveleve me te larta per kete zone (ne rast se ka ). Kjo flete mund te tregojë gjithashtu edhe funksionet kryesore te propozuare nga ana juaj (zonimin funksional ) dhe menyren e lidhjes me qytetin. Shkalla e paraqitjes do te jete 1:10 000, 1:5000 ose cdo shkalle tjetër qe mund te tregojë gjithë qytetin ose pjese te konsiderueshme te tij .
  - 4- **Planimetri e cila te permbaje studimin plan volumor te propozuar** . Kjo do te jete fleta kryesore ne te cilen do te shprehen idete kompozicionale dhe sinteza e gjithë analizave te bera . Shkalla e paraqitjes do te jete sipas nevojës.
  - 5- **Skema e rrjetit rrugor te zones** ne studim, parkimet dhe menyra e lidhjes se tyre me sistemin e qytetit dhe rruget kryesore te zones. Ketu te tregohen gjithashtu seksionet rrugorë dhe elementet kryesore te tyre. Skema e levizjes kembesore ku te tregohet lidhja e te gjitha banesave , parkimeve , zonave tregetare, etj . Skema e levzjes kembesore te jete e lidhur me sistemin e gjelberimit te qytetit . Shkalla e paraqitjes te jete sipas nevojës. Sipas rasti keto dy skema (levizja kembesore dhe sistemi i gjelberimit ) mund te jepen ne te njejten planimetri ose ne planimetri te vecanta .
  - 6- **Pamjet panoramike** (te pakten dy ) gjate rrugeve kryesore ku te evidentohen pikat me te rendesishme te siluetes te zones se propozuar ne studim. Shkalla e paraqitjes te jete 1:500 , 1:250 .
  - 7- **Relievi i zones**, madhesia e se cilit percaktohet nga zyra e urbanistikes.
  - 8- **Gen – plani i azhornuar me gjendjen faktike te zones** i hartuar nga sektori i kadastres urbane, ne te cilin te jete hedhur vija e ndertimit. Te gjitha keto ne format dwg ( ky genplan del me vulen e Bashkise ).
  - 9- **Dokumenti i pronesise** mbi token ( dokumenti hipotekor shoqerohet me harten treguese dhe kopje karte), ky duhet te jete i tremujorit te fundit. Ne dokumentin e prones duhet te jete i shprehur ne m<sup>2</sup> ne total siperfaqja e prones.
  - 10- **Dokumentacion fotografik i zones**, nga disa pika veshtrimi, me madhesi te pershtatshme.
  - 11- **Licensa e arkitektit ose urbanistit** qe ka kryer studimin me shenimin perkates per objektin.
  - 12- **Fotomontazhi** mbi gjendjen egzistuese.

## KERKESE PER LEJE SHESHI

- Dokumentet e nevojshme per pajisjen me leje per shesh ndertimi :
1. **Formulari tip kerkese Nr.1** dhe **Nr.6** (per prerjen e drureve) e **Nr.8** (per prishjen e ndertimeve egzistuese) ne rast se nevojiten
  2. **Dokumenti i pronesise** mbi token (dokumenti hipotekor shoqeruar me harten treguese dhe kopje karte). Ky duhet te jete i tremujorit te fundit . Ne dokumentin e prones duhet te jete e shprehur ne m<sup>2</sup> ne total siperfaqja e prones, numri i pronesise dhe kufitaret. Mundesisht te paraqitet skice e permasuar e pronesise nga ZRPP.

3. **Gen plan azhornimi** me gjendjen faktike te zones, si **dhe vija e ndertimit**, ne shkallen nga 1:100 deri ne 1:500 ne format A3, A4 e konfirmuar nga sektori i kadastrës urbane prane Bashkise Korçe, ky gen – plan del me vulen e Bashkise.
4. **Formulari Nr 3/1** se bashku me azhornimet e infrastruktures te hedhura ne gen-planin e permendur ne piken 3 (i fotokopjuar).Ndermarrjet ku merren keto azhornimendodhen si me poshte :
  - Ndermarrja e ujesjellesit
  - Ndermarrja e kanalizimeve te ujrave te zeza
  - Ndermarrja elektrike
  - Ndermarrja e telekomit
  - Ndermarrja e mbrojtjes kundra zjarrit
  - Agjensia Rajonale e Mjedisit
  - Inspektoriati Sanitar Shteteror
5. **Studim urbanistik pjesor i zones** ku do te ndertohet objekti. Studimi do te behet nga arkitekt i licensuar per kete kategori dhe te jete i firmosur e vulosur me firme origjinale nga ai. Bashkengjitur edhe licensen me shenimin perkates te arkitektit per objektin. Ne rast se ka studimte miratuar vendoset nje kopje e tij.
6. **Planvendosja e objektit** , ne shkalle 1:500 me permasa dhe distance nga kufijte e prones dhe aksi i rruges e cila do te punohet mbi genplanin e hartuar nga sektori i Kadastrës Urbane ( pika 3). Kjo do te jete e firmosur nga arkitekti. Ne pjesen e sipërme te jete shkruar qarte objekti, numri i kateve, rruga ku do te ndertohet dhe pronaret e truallit. Gjithashtu duhet te hidhen gjurmet e te gjitha kateve.
7. **Relacion shpjegues i studimit** dhe projektit pergatitur nga projektuesi, firmosur nga ai, me firme origjinale.
8. **Pamje panoramike** e studimit si dhe projekti arkitektonik ne fazen e projekt idese
9. **Sistemet e jashtme**, sheshe, gjelberim, parkime, rruge si dhe skemat e levizjeve te kembesoreve, makinave dhe piken e hedhjes se mbeturinave per banesat kolektive.Skema duhet paraqitur ne shk 1:500 per studime dhe ne shk 1:200, 1:250 per objekte te vecanta
10. **Fotomontazhi i objektit** te kerkuar mbi foton e gjendjes egzistuese.
11. **Marreveshje me deklarate noteriale me pronarin e prones kufitare** ku te theksohen numri i pasurive te pronareve kufitare te cilet japin kete deklarate. Vlen ne menyre taksative per banesa kolektivedhe te ruhet distance prej 25 cm per banesa individuale.
11. **Leja nga Instituti i Monumenteve te Kultures** ne ato zona ose objekte qe jane nen mbrojtjen e ketij institucioni.
12. **Studim nga Instituti i Sizmikes** per objekte mbi 8 kate
13. **Studimi Gjeologjik** per ndertesa mbi 5 kate
14. **Dokumentacioni fotografik i zones** nga disa pika veshtrimi, me madhesi te pershtatshme

## SHENIM :

16. **Materiali** i mesiperme duhet te paraqitet **ne 2 kopje dhe I GJITHE MATERIALI I PROJEKTUAR DUHET TE JETE I PARAQITUR NE KOPJE ELEKTRONIKE NE NJE CD** ku te jete paraqitur projekti arkitektonik (planimetri, pamje, prerje, 3 D,fotomontazh).

## KERKESE PER LEJE NDERTIMI

LISTA E DOKUMENTAVE TE CILAT DUHET TE PLOTESOJNE DOSJEN PER LEJE NDERTIMI & ZBARDHJE

- Dokumentet e nevojshme per pajisjen me leje ndertimi :

1. **Formulari tip kerkesë Nr.3**
2. **Formulari Nr.2** i lejes se aprovuar te sheshit te ndertimit

3. **Relacion teknik shpjegues** i studimit te projektit i firmosur nga projektuesit me firme origjinale ne dy kopje (arkitekt, konstruktor).
4. **Fotokopje e licensave te projektueseve** brenda afatit te perdorimit me shenimin perkates.
5. **Te dhenat e studimit gjeologo- inxhinierik**, per sheshin e ndertimit.
6. **Te dhenat e studimit inxhiniero – sizmologjik** per sheshin ku do te behet ndertimi ( per objekte mbi 8 kate); .....
7. **Fleta e rifiniturave e detajuar** per Ansamblin Arkitektonik, Urbanistik, Tradicional; Qendren Historike dhe banesat kolektive ne te cilen te shenohet edhe emri i kryetarit te KRRT Bashkise.
8. **Projekt zbatimi i plote** ne dy kopje ( sipas vendimit, formularit dhe genplanit te lejes se ndertimit) : arkitekture, konstruksion, eklektrik, hidrosanitar, ngrohje, kurse ventilimi per objektet kolektive, i firmosur nga projektuesit me firme origjinale, i shoqeruar me tabelen e fleteve per secilin projekt.
9. Ne projektin e zbatimit **te jepen te saktuesuar tipet e apartamenteve**, siperfaqet per secilin tip dhe sasia e tyre, per cdo objekt me destinacion banese.
10. **Planimetria e sistemimeve te jashtme** te plotesuara me kuota altimetrike, ne 2 kopje (bashkengjitur projekt zbatimit) e firmosur nga projektuesi me firme origjinale. Ne sistemimet e jashtme perfshihet i gjithe reabilitimi i pjeseve te demtuara.

Dokumentata e nevojshme per zbardhjen e lejes se ndertimit pas vendimit te miratimit Lejes se Ndertimit nga KRRT – ja :

11. **Kontrata noteriale midis pronarit te truallit dhe firmes se ndertimit**, si dhe licensa profesionale e tatimore e noteruar e firmes se ndertimit brenda afatit te perdorimit
12. **Plani i organizimit te punimeve + grafiku i punimeve**, ne dy kopje (bashkengjitur project zbatimit, i firmosur nga drejtuesi teknik i subjektit ndertues me firme origjinale
13. **Preventivi** i hartuar mbi bazen e cmimit mesatar per meter katror i firmosur me firme origjinale
14. **Vertetim nga Tatimet**, dokument i cili i jepet firmes ndertuese per te vertetuar qe ky subject nuk ka detyrime te pashlyera
15. **Vertetim nga Policia e Ndertimit**

### SHENIM :

Materiali i mesiperm duhet te paraqitet ne dy kopje dhe I GJITHE MATERIALI I PROJEKTUAR DUHET TE JETE I PARAQITUR NE KOPJE ELEKTRONIKE NE NJE CD, ku te jete paraqitur projekti arkitektonik (planimetri, pamje, prerje, fotomontazh).

## KERKESE PER LEJE SHFRYTEZIMI

### LISTA E DOKUMENTAVE TE CILAT DUHET TE PLOTESOJNE DOSJEN PER LEJE SHFRYTEZIMI

- Kerkesat per dhenien e lejes se shfrytezimit :

1. **Kerkesa per leje shfrytezimi** behet nga investitori ose subjekti ndertues dhe shoqerohet me dokumentacionin e poshteshenuar :
  - **Fotografi** te fasadave te objektit
  - **Relacion i kolaudatorit** per zbatimin e projektit, ku te reflektohen te gjitha ndryshimet e bera ne projektin e miratuar. (Te evidentohen shkeljet nese ka dhe si jane plotesuar punimet e maskuara).
  - **Certifikatat e cilesise se materialeve te perdorura ne ndertim**

- **Licensa e autorit**
- **Relacion i supervizorit** mbi zbatimin e objektit
- **Licensa e supervizorit**
- **Licensa e drejtuesit teknik**
- **Vendim i KRRT-se per shesh ndertimi**
- **Vendim i KRRT-se per leje ndertimi**
- **Formularet Nr.2 dhe Nr.4** (per shesh e leje ndertimi)
- **Genplani i miratuar** sipas lejes se ndertimit
- **Projekti i miratuar** nga KRRT Bashkise (Plani i katit te podrumit, Plani i kati perdhe, Planet e katit tip, Plani i tarraces, Prerjet dhe Pamjet e objektit)
- **Licensat e projektueseve** (Arkitekt, konstruktor) me shenimin perkates
- **Aktet e kontrollit** per fazat e ndertimit te objektit ( Akti i piketimit, Akti i kontrollit te 0.00, Akti i kontrollit te perfundimit te karabinase, Akti i kontrollit te sistemimit te jashtem + perfundimi i rifiniturave).
- **Akt marreveshja** midis firmes ndertuese dhe pronarit te truallit
- **Vertetim nga zyra e Sherbimeve Publike** per percaktimin dhe kontrollin e pikes se hedhjes se mbeturinave dhe per perfundimin e sistemimit te jashtem.
- **Vertetim nga Tatim – Taksat**, sipas se cilit vertetohet se subjekti ndertues i ka shlyer te gjitha detyrimet ndaj tatim taksave.
- **Vertetim nga Policia e Ndertimit**
- **Vertetim nga Inspektoriati Higjeno – Sanitar**
- **Relacion mbi zbatimin e objektit.**

## KERKESE PER LEGALIZIM NDERTIMI

### DOKUMENTAT TEKNIKO – LIGJORE PËR LEGALIZIMIN E SHITESAVE NË NDËRTIME ( PAS VITIT 1993 ) - FORMULARI A1 ME LEJE

Sipas ligjit nr 9482 date 03.04.2006 “ Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje “ Subjekti duhet të paraqesë pranë zyrave të Urbanistikës këto dokumenta :

1. Deklaratën noteriale, ku projektuesi i licënsuar i konstruksionit të ndërtimit, zbatuesi dhe investitori që garantojnë së bashku qëndrueshmërinë konstruktive të objektit .
2. Oponencën e institucioneve të specializuara, Institutit të studimeve dhe projekttimeve Urbanistike apo fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për qëndrueshmërinë e objektit në Legalizim. ( Brenda një afati të caktuar pas datës së lidhjes së akt-marrveshjes ).
3. Në rast kur të interesuarit nuk mund të sigurojë dokumentin sipas pikës së dyte, atëherë i interesuari është i detyruar të paraqesë një akt-ekspertimi nga një ekspert ose ent i licënsuar për qëndrueshmërinë konstruktive të Objektivit .
4. Akt-marrveshjen me pronarin e truallit për shtesën anësore nëse është ndërtuar shtesë në truall privat. Kur subjekti ndërtues dhe pronari i truallit nuk kanë marrveshje të veçantë për shtesën pa leje, pjesë përbërëse e dokumentacionit do të jetë marrveshja që kanë për ndërtimin e investimit kryesor .
5. Akt-marrveshja noteriale për ndarjen e pjesëve takuese dhe fizike të pronës.( n.q.s ka )
6. Vendimet e K.RR.T-së / K.RR.T.SH-së për lejen e sheshit dhe lejen e ndërtimit, kopje të noterizuara .
7. Planimetrinë e çdo kati në shkallën 1:100, të përpiluar nga një inxhinier i licënsuar në këtë fushë, ku të jenë të paraqitur në mënyrë të dallueshme shtesa tej lejes së ndërtimit të miratuar nga K.RR.T-ja, sipërfaqen e shtesës, kuotën e katit, sipas formatit tip të miratuar nga Drejtoria Qëndrore e ALUIZNI-t .
8. Projektin e plotë teknik të miratuar, origjinali dhe dy kopje .

9. Planvendosjen e objektit, bazuar te planvendosja e lejes së sheshit, lejes së ndërtimit të miratuar nga K.RR.T-ja në tre kopje. Genplanin e azhornuar të objektit. Në rast se subjekti disponon genplan të përgatitur nga specialistët e Drejtorisë së Legalizimeve paraqitet rikonfirmimi i tij .
10. Për shtesat anësore mbi truall public duhet të paraqesin kërkesën tuaj për kalimin e pronësisë ( kërkesa drejtuar këshillave përkatës të njësive të qeverisjes vendore ) .
11. Deklaratën e pranimit të planit Rregullues .
12. Deklaratën personale .
13. Foto të objektit, 4 pamjet .
14. Çertifikatë familjare për rastet e objekteve për banim dhe jo për qëllim shit-blerje apo tregti
15. Çertifikatë pronësie për truallin dhe/ose dokument tjetër. Nëse ka dhe për shtesën anësore .
16. Për shtesat anësore mbi pronë publike të paraqitet kërkesë për kalimin në pronësi të truallit.
17. Vendimin dhe/ose shkresën e gjykatës për pezullimin e procedurave të legalizimit, ose për vendosje mase sigurie .
18. Deklaratën e zgjedhjes së objektit dhe e heqjes dorë nga përfitimi, në rastet e dy a më shumë ndërtimeve pa leje, të deklaruara nga i njëjti subjekt .
19. Kur vetëdeklarimi kryhet Brenda dy muajve të dytë (15shtator-15nëntor ) të procesit të vetdeklarimit mandat-pagesat e sanksioneve dhe llogaritja e tyre nga punonjesi i njesisë së legalizimit ( sipas sanksionit të ligjit 9482 datë 03.04.2006 neni 8 ) .
20. Dokumentacioni i Dosjes së Legalizimit .

**DOKUMENTAT TEKNIKO – LIGJORE PËR LEGALIZIMIN E SHITESAVE NË NDËRTIME**  
**( PAS VITIT 1993 ) - FORMULARI A1**

Sipas ligjit nr 9482 date 03.04.2006 “ Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje “

Subjekti duhet të paraqesë pranë zyrave të Urbanistikës këto dokumenta :

1. Akt-marrëveshjen me pronarin e truallit për shtesën anësore nëse është ndërtuar kjo shtesë në truall privat . Kur subjekti ndërtues dhe pronari i truallit nuk kanë marrëveshje të veçantë për shtesën pa leje, pjesë përbërëse e dokumentacionit do të jetë marrëveshja që kanë për ndërtimin e investimit kryesor .
2. Akt-marrëveshja noteriale për ndarjen e pjesëve takuese dhe fizike të pronës. (n.q.s ka )
3. Planimetrinë e çdo kati në shkallen 1:100, të përpiluar nga një inxhinier i licencuar në këtë fushë, ku të jenë të paraqitur në mënyrë të dallueshme shtesa, sipërfaqen e shtesës, kuotën e katit, sipas formatit tip të miratuar nga Drejtoria Qëndrore e ALUIZNI-t .
4. Planvendosjen e objektit / Genplanin e azhornuar të objektit . Në rast se subjekti disponon genplan të përgatitur nga specialistët e Drejtorisë së Legalizimeve paraqitet rikonfirmimi i tij .
5. Për shtesat anësore mbi truall publik duhet të paraqesin kërkesën për kalimin e pronësisë (kërkesa drejtuar këshillave përkatës të njësive të qeverisjes vendore ) .
6. Deklaratën e pranimit të planit Rregullues .
7. Deklaratën personale .
8. Foto të objektit, 4 pamjet .
9. Çertifikatë familjare për rastet e objekteve për banim dhe jo për qëllim shit-blerje apo tregti
10. Çertifikatë pronësie për truallin dhe/ose dokument tjetër. Nëse ka dhe për shtesën anësore .
11. Për shtesat anësore mbi pronë publike të paraqitet kërkesë për kalimin në pronësi të truallit.
12. Vendimin dhe/ose shkresën e gjykatës për pezullimin e procedurave të legalizimit, ose për vendosje mase sigurie .
13. Deklaratën e zgjedhjes së objektit dhe e heqjes dorë nga përfitimi, në rastet e dy a më shumë ndërtimeve pa leje, të deklaruara nga i njëjti subjekt .

14. Kur vetëdeklarimi kryhet Brenda dy muajve të dytë (15shtator-15nëntor ) të procesit të vetdeklarimit mandat-pagesat e sanksioneve dhe llogaritja e tyre nga punonjesi i njesisë së legalizimit ( sipas sanksionit të ligjit 9482 datë 03.04.2006 neni 8 ) .
15. Dokumentacioni i Dosjes së Legalizimit .

DOKUMENTAT TEKNIKO – LIGJORE PËR LEGALIZIMIN  
E NDËRTIMEVE PALEJE - FORMULARI A

Sipas ligjit nr 9482 date 03.04.2006 “ Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje “

Subjekti duhet të paraqesë pranë zyrave të Urbanistikës këto dokumenta :

1. Akt-marrëveshjen me pronarin e truallit për objektin nëse është ndërtuar në truall privat .
2. Akt-marrëveshja noteriale për ndarjen e pjesëve takuese dhe fizike të pronës.( n.q.s ka )
3. Planimetrinë e çdo kati në shkallen 1:100, të përpiluar nga një inxhinier i licensuar në këtë fushë, ku të jenë të paraqitur në mënyrë të dallueshme : sipërfaqen e ndërtimit, kuotën e katit, sipas formatit tip të miratuar nga Drejtoria Qëndrore e ALUIZNI-t .
4. Planvendosjen e objektit, / Genplanin e azhornuar të objektit . Në rast se subjekti disponon genplan të përgatitur nga specialistët e Drejtorisë së Legalizimeve paraqitet rikonfirmimi i tij .
5. Çertifikatë pronësie për truallin dhe/ose dokument tjetër.
6. Për objektet e ndërtuara mbi truall publik duhet të paraqesin kërkesën për kalimin e pronësisë ( kërkesa drejtuar këshillave përkatës të njësive të qeverisjes vendore ) .
7. Deklaratën e pranimi të planit Rregullues .
8. Deklaratën personale .
9. Foto të objektit, 4 pamjet .
10. Çertifikatë familjare për rastet e objekteve për banim dhe jo për qëllim shit-blerje , tregti apo shërbim )
11. Vendimin dhe/ose shkresën e gjykatës për pezullimin e procedurave të legalizimit, ose për vendosje mase sigurie ( në qoftëse ka ) .
12. Deklaratën e zgjedhjes së objektit dhe e heqjes dorë nga përfitimi, në rastet e dy a më shumë ndërtimeve pa leje, të deklaruara nga i njëjti subjekt .
13. Kur vetëdeklarimi kryhet brenda dy muajve të dytë (15shtator-15nëntor ) të procesit të vetdeklarimit mandat-pagesat e sanksioneve dhe llogaritja e tyre nga punonjesi i njesisë së legalizimit ( sipas sanksionit të ligjit 9482 datë 03.04.2006 neni 8 + Tarifat ) .

**KERKESAT PLOTESUESE QE DUHET TE PERMBUSHIN**  
**OBJEKTET NE BULEVARD “REPUBLIKA”**

Kerkesat plotesuese qe duhet te permbushin projektet qe do te paraqiten per miratim ne KRRT Bashkise, ne bulevard “Republika” :

- Objektet duhet te jene te terhequra nga rruga dhe nga prona duke krijuar **oborr, me perjashtim te objekteve egzistuese qe rikonstruktohen dhe nuk dalin nga volumet egzistuese;**
- **Dritaret dhe dyert te jene te kornizuara** me elemente te miredetajuara dhe te paraqitura me prerje ne flete te vecanta te projektit;

- Rrethimi te kryhet me **mur guri** te punuar dhe me **kangjell**;
- Te paraqiten ne tekniken bardhe e zi fasadat e vazhduara, d.m.th fasadat e objektit perkates si dhe fasadat e objekteve fqinje;
- Detajimi ne menyre te hollesishme i te gjitha elementeve te perdorura; korniza, frizura, dekoracione etj.
- Hyrjet e objekteve te trajtohen me kolona guri te cilat te jepen te detajuara ne fletet perkatese.
- Nuk lejohet perdorimi i mermerit.
- Nuk lejohet dalja me konsol ne rruge.

**MARSILA BITRI**

---

**SEKRETARIA TEKNIKE KRRT**

**NIKO PELESHI**

---

**K R Y E T A R**